



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 971/2 Prot.

Tiranë, më 11.09.2023

V E N D I M

Nr. 176, Datë 11.09.2023

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën nr. 160, datë 29.08.2023, të paraqitur nga A.H kundër Avokatit të Popullit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “gjendjes civile”, “përgjegjësisë prindërore”, “bindjes politike” dhe “çdo shkak tjetër”¹.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, ankuesi në mes të tjerash informon se: “I jam drejtuar me një ankesë institucionit të Avokatit të Popullit, protokolluar pranë tij me nr. K2/A7-1, datë 03.03.2020. Ankesa drejtohej kundër tre institucioneve, Ministrisë së Brendshme dhe dy institucioneve në varësi të saj, Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) dhe Policisë së Shtetit (Komisariatit të Policisë Vlorë), në të cilën kam kërkuar nga Avokati i Popullit ndërmarrjen e një procesi hetimi, në lidhje me veprimet dhe mos veprimet e paligjshme e të parregullta, të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave dhe Policisë së Shtetit.

Me datën 31.08.2020 nëpërmjet shërbimit postar, më është dorëzuar përgjigjja e ankesës së bërë prej meje. Pasi e kam lexuar kam mbetur i zhgënjyer, i tallur dhe i fyer nga përgjigjja, pa përgjigje e Avokatit të Popullit. Jam ndier thellësisht i diskriminuar.

¹ Të qenit burrë, i divorcuar, prind kujdestar i një vajze të mitur, simpatizant aktiv i një partie politike (PD) dhe fakti që Avokati i Popullit më ka kosideruar dhunues në familje, bazuar në një informacion të rremë të servurur me dashje nga SHÇBA.

Pas marrjes së përgjigjes nga Avokati i Popullit, me datën 03.09.2020 i kam drejtuar Znj. E.B një ankesë në adresën e postës elektronike zyrtare. Asnjë nga ankesat e mija dërguar me e-mail te drejtuesja e një institucioni Kushtetues nuk mori përgjigje prej saj.

Përse mendoj se ka diskriminim:

- 1. Ankesa ime edhe pse është pranuar për hetim nuk i është nënshtruar hetimit administrativ, ndërsa për pjesën e ankesës kundër SHÇBA, Avokati i Popullit ka ndryshuar faktet me qëllim për mos kryerjen e hetimit administrativ.*
- 2. Drejtuesja e institucionit ka injoruar tërësisht ankesat e mija kundër punonjësve të institucionit dhe asaj vetë.*
- 3. Ankesa është mbajtur 6 muaj pa përgjigje, kohë relativisht e gjatë, pasi Avokatit të Popullit i është dashur vetëm përgjigjja e një shkrese për të kryer “hetimin”. Gjatë kësaj kohe unë kam patur komunikime telefonike, postë elektronike dhe letërkëmbim, pasi përgjigjja vonohej pa shkak.*
- 4. Trajtimi i ankesës nuk i është nënshtruar procedurës së parashikuar nga Rregullorja e Brendshme e institucionit.*
- 5. Përgjigjja nuk është e argumentuar ligjërisht, mungojnë referencat ligjore që kanë çuar Avokatin e Popullit në ato përfundime.*

Në mënyrë cinike Avokati i Popullit me qëllim denigrimin tim, më rekomandon ... “ju sugjerojmë që konfliktet që keni me ish bashkëshorten, një prej tyre dhe ai i banesës duhet ti trajtoni me durim dhe maturi dhe ti zgjidhni në rrugë ligjore.....”. Thuaj sikur unë i isha drejtuar Avokatit të Popullit për problemet e mija familjare, ndërkohë që të gjitha këto probleme ishin zgjidhur nga gjykatat me vendime të formës së prerë, vite më parë, në favorin tim”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e çdo mase që Komisioneri do ta vlerësoj të nevojshëm.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët,

të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Ankesa nuk pranohet kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”. Parashikimi i sipërcituar nuk është kumulativ dhe kërkon si kriter për mospranimin e ankesës, plotësimin e njërit prej kushteve të mësipërme.

Referuar informacionit të cituar në ankesë dhe materialeve bashkëngjitur saj, rezulton se periudha e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është në datë 31.08.2020, fakt i cili është pohuar dhe nga vetë ankuesi gjatë parashtrimit të fakteve. Ndërkohë që, edhe data e konstatimit të diskriminimit nga ana e ankuesit është 31.08.2020, datë në të cilën ai citon se ka marrë përgjigjen nga Avokati i Popullit për ankesën e bërë prej tij në datë 03.03.2020.

Për sa më sipër, KMD gjykon se momenti i ndodhjes së diskriminimit të pretenduar është data 31.08.2020, kur ankuesi ka marrë shkresën “Kthim përgjigje” nga Avokati i Popullit me nr. K2/A7-3 Prot, datë 28.08.2020. Edhe momenti i marrjes dijani nga ankuesi mbi sjelljen diskriminuese të pretenduar nga ana e Avokatit të Popullit është data 31.08.2020. Ndërkohë që, data e depozitimit të ankesës pranë KMD-së është 29.08.2023. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se momenti, i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar, daton më vonë se 2 (dy) vjet nga data e depozitimit të ankesës nr. 160, datë 29.08.2023 pranë KMD-së.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr. 160, datë 29.08.2023, të A.H, pasi është jashtë afateve ligjore për t’u shqyrtuar nga ky institucion.

² Për analogji shih vendimet nr. 64, datë 27.04.2023 dhe nr. 167, datë 23.08.2023 të Komisionerit.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj³, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “dh” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 160, datë 29.08.2023, të paraqitur nga A.H kundër Avokatit të Popullit, pasi është paraqitur tej afateve ligjore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³ Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar: “Procedura para gjykatës”.